



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution**

Data: 8 korrik 2016

Raport mbi monitorimin e Qendrave të Paraburgimit në Mitrovicë dhe Prizren

Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë

Hyrje

Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë funksionon si Qendër Paraburgimi që nga viti 1999, por në të njëjtën kohë edhe si vend ku janë të akomoduar të burgosurit të dënuar në periudha kohore të gjata. Ky është një prej problemeve më thelbësore të kësaj qendre pasi që kapacitetet e vet qendrës nuk janë të parapara për vendosjen e të burgosurve të dënuar në periudha kohore të gjata. Për sa i përket kapacitetit, numri mesatar i të burgosurve të vendosur në këtë qendër është përafërsisht 40 gjersa kapaciteti i përgjithshëm i qendrës është 56 të burgosur. Të burgosurit e vendosur në këtë qendër janë kryesisht nga pjesa veriore e Kosovës por transferimi nga qendrat tjera të paraburgimit është i mundshëm me kërkesë të paraburgosurit ose të burgosurit.

Keqtrajtimi

Ekipi monitorues nuk ka pranuar rishtazi ndonjë pohim mbi keqtrajtimin fizik ose ushtrimin e shtuar të dhunës nga ana e personelit të shërbimit korrektues.

Kushtet e paraburgimit

Kushtet materiale

Kushtet e akomodimit janë të mira, dhomat janë të rinovuar dhe secila ka tualet, dritë të mjaftueshme natyrale dhe ngrohja gjatë periudhës së dimrit në këto hapësira është e mirë. Të paraburgosurit i pastrojnë vet hapësirat dhe pastërtia e tyre është në nivel të kënaqshëm. Të paraburgosurit të vendosur në këtë qendër mund të bëjnë dush në banjo të përbashkët një herë në dy ditë por ata që punojnë, këtë mund ta bëjnë çdo ditë. Çdo dhomë ka TV. Rrobat zakonisht sigurohen nga familja derisa uniforma ipet nga qendra e paraburgimit.

Qendra e paraburgimit nuk ka fonde të mjaftueshme (nuk ka para, Qendra nuk është në gjendje të ofroj sasi të mjaftueshme të rrobave për ata të cilët kanë nevojë për to). Të burgosurit kanë sasi të mjaftueshme çarçafësh për shtretër dhe larja e tyre bëhet një herë në javë por me kërkesë kjo mund të bëhet edhe më shpesh. Kuzhina është në gjendje të mirë, çdo i burgosur merr tri shujta të rregullta për çdo ditë derisa për ata që punojnë në punëtori të zdrukthëtarisë, Qendra për ta siguron sasi më të madhe të qumështit.

Regjimi

Ekipi monitorues është njoftuar se disa nga të burgosurit janë të kyçur në punë si zdrukthëtare. Disa të tjerë janë të angazhuar për të punuar në kuzhinë, si dhe ca të tjerë merren me pastrimin e rrobave. Të paraburgosurit dhe të burgosurit kanë pasur një varg trajnimesh të ndryshme, si për shembull për gjellëbërës, saldues dhe rrobaqepës. Kurset për kompjuter janë ofruar por edhe ato për administrim të biznesit duhet të organizohen gjithashtu. Personat e privuar nga liria këtu kanë të drejtë në shëti në ajër të pastër dy herë në ditë, njëra zgjatë një orë gjersa tjetra 30 minuta. Qendra po ashtu posedon pajisje për fines, e cila është e vendosur në oborr. Për sa i përket religjionit, kleriku viziton ketë qendër gjatë periudhave të agjërimit. Kur bëhet fjalë për ngjarjet kulturore është mirë të cekim se është organizuar një manifestim me 25 qershor të vitit 2016 në oborr të Qendrës së Paraburgimit. Mundësia për mësim i ofrohet çdo personi të vendosur këtu, por fillimisht atyre që nuk dijen shkrim-lexim dhe të rinjve.

Kujdesi shëndetësor

Shërbimet mjekësore duken të jenë mirë të organizuara. Qendra ka ordinancën stomatologjike ku ofrohen shërbimet e stomatologjisë dy herë në javë. Mjekët e praktikës së përgjithshme e vizitojnë qendrën madje më shpesh me kërkesë, derisa në rastet e hospitalizomi të burgosurit vendosen në Qendrën Klinike të Mitrovicës. Nëse ka nevojë të paraburgosurit dhe të burgosurit dërgohen edhe në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës gjithashtu. Ekipi monitorues është informuar se ka pasur disa raste gjatë vitit 2015 kur mjekët e praktikës së përgjithshme të EUEX-it e kanë vizituar qendrën e paraburgimit gjithashtu. Psikologu viziton qendrën në baza të rregullta.

Çështjet tjera

Personeli i burgut

Ekipi monitorues është njoftuar se gjatë këtij viti ka pasur një rritje të rekrutimit të personelit për 25%.

Disiplina

Sipas legjislacionit relevant (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale), personat e dënuar mund të ndëshkohen me këto dënime disiplinore: qortim, privim nga privilegjet e caktuara, urdhri për kompensim dhe mbylljes në vetmi deri në 15 ditë. Të paraburgosurit mund të dënohen me ndalim ose kufizim të vizitave ose të korrespondencës (përveç kontakteve me mbrojtësin, Avokatin e Popullit, përfaqësuesit e misionëve diplomatike, etj.), nëse kanë kryer ndonjë shkelje disiplinore të veçantë të cekura në ligj (asnjera nga këto nuk është e lidhur me të drejtat e të burgosurve që të kenë kontakt me botën e jashtme). Ekipi monitorues nuk ka pranuar asnjë ankesë lidhur me këtë.

Kontakti me botën e jashtme

Sipas legjislacionit në fuqi, vizitat për të paraburgosurit janë të autorizuara dhe nën monitorim vetëm nga gjyqtari i procedurës paraprake. Ekipi monitorues është njoftuar se të paraburgosurit kanë të drejtë të pranojnë vizita një herë në javë me leje të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake, derisa të burgosurit dy herë në javë. Nuk është dorëzuar asnjë ankesë nga të paraburgosurit ose të burgosurit.

Procedura e pranimit

Pranimi bazohet në vendimin e gjykatës. Para se të akomodohen të burgosurit, personeli i administratës bënë fotot e tyre dhe kryen çështjet tjera administrative të parapara me ligj. Ekipi monitorues vëren se zyra e pranimit i kushton vëmendje të duhur procedurës së pranimit dhe regjistrimit.

Ankesat dhe procedurat

Të paraburgosurit dhe të burgosurit mund të parashtrojnë ankesat e tyre tek menaxhmenti i qendrës së paraburgimit dhe tek Avokati i Popullit përmes kutive për ankesa në çdo krah të qendrës. Për sa i përket kutive për ankesa të vendosura nga Avokati i Popullit, vetëm personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit ka qasje në to. Ekipi monitorues është informuar se nga të paraburgosurit dhe të burgosurit se zakonisht menaxhmenti përgjigjet në kërkesat dhe ankesat e tyre pa vonesë.

Konkludim:

-Autoritetet relevante duhet të ndërmarrin masat e duhura për të siguruar kushte të duhura për të burgosurit e dënuar me burgim afatgjatë.

Qendra e paraburgimit në Prizren

Hyrje

Kjo qendër u themelua në vitin 1963. Në të janë të akomoduar personat e paraburgosur dhe ata të dënuar. Në kohën e vizitës në këtë qendër ishin të akomoduar 63 persona të paraburgosur dhe 20 persona të dënuar. Kapaciteti i përgjithshëm është 92 vende. Në krahun A, B, C janë të vendosur të paraburgosurit, derisa në atë D janë të vendosur të burgosurit. Ekipi monitorues është informuar nga menaxhmenti i qendrës së paraburgimit se Ministria e Drejtësisë planifikon të ndërtoj një qendër paraburgimi të re në Prizren, e cila sipas tyre do të bëhet brenda dy viteve. Sidoqoftë, kjo informatë duhet të konfirmohet nga Ministria e Drejtësisë.

Keqtrajtimi

Gjatë vizitës ekipi monitorues ka zhvilluar disa intervista me të paraburgosurit dhe të burgosurit. Ekipi monitorues nuk ka pranuar ndonjë pohim mbi keqtrajtim fizik rishtazi ose ushtrim të tepruar të dhunës nga ana e personelit në qendrën korrektuese.

Kushtet e paraburgimit

Kushtet materiale

Kushtet materiale në krahun ku personat e paraburgosur dhe të burgosur ishin të akomoduar, ndryshonin në masë të madhe. Ekipi monitorues ka vërejtur se qelitë ku mbahen të paraburgosurit nuk ishin në pajtim me standardet e caktuara të KPT (Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës). Hapësirat nuk ishin të mjaftueshme për të akomoduar 4 të burgosur. Ekipi monitorues gjithashtu ka vërejtur se nuk kishte dritë natyrore të mjaftueshme dhe ventilim. Ekipi monitorues ka vërejtur se në menzën (salla e ngrënies) e dedikuar për të paraburgosurit në krahun C nuk kishte dritë të mjaftueshme natyrore dhe ventilim. Ekipi monitorues ka ardhur në përfundim se qelitë ku të burgosurit ishin të akomoduar në përgjithësi ishin në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe ato të KPT-së. Monitoruesit vërejtën se qelitë nuk ishin të mbipopulluara. Për

sa i përket dushit, të burgosurve ju lejohet të bëjnë dush në çdo kohë, derisa të paraburgosurve çdo të tretën ditë. Të paraburgosurit dhe të burgosurit e kanë njoftuar ekipin monitorues se prej ca muajve artikujt higjienik nuk sigurohen nga qendra dhe se shumicën e artikujve të tillë ata i sigurojnë nga familjet e veta. Sipas menaxhmentit problemi do të zgjidhet shumë shpejtë meqë procedurat e tenderit për përzgjedhje të kompanisë që do të bëjë furnizimin e qendrës me këta artikuj, ka përfunduar. **Ekipi monitorues do të monitoroj situatën dhe do të kërkoj nga autoritetet relevante të ofrojnë informata të azhurnuara lidhur me këtë çështje.** Ekipi monitorues vizitoi kuzhinën dhe vërejti se ajo ishte e pastër dhe e mobiluar me pajisje të reja dhe dritë të mjaftueshme natyrale. Sipas personelit në kuzhinë, ata ishin të pajisur mirë me pajisje të kuzhinës, posaçërisht me frigoriferë. Personeli në kuzhinë ishin të pajisur me certifikata valide mjekësore. Sipas personelit mjekësor, cilësia e ushqimit dhe kuzhina kontrollohen nga mjeku i burgut një herë në javë.

Regjimi

Ekipi monitorues u njoftua se një numër i të burgosurve ishin të përfshirë në punë. Sipas intervistave me të burgosurit dhe zyrtarët e menaxhmentit duket se të burgosurve zakonisht u mundësohen ushtrimet në ambient të hapur çdo ditë prej orës 09:00 gjerë më 19:00. Në rastin e të paraburgosurve shëtitjet në ambient të hapur mundësohen një orë para mesditës dhe një orë pas dite. Ekipi monitorues ka vërejtur se ekziston biblioteka në qendër në të cilën gjenden një numër librash. Megjithatë, nuk ka aktivitete tjera ose trajnime profesionale gjerë më tani.

Kujdesi shëndetësor

Kujdesi shëndetësor sigurohet nga Ministria e Shëndetësisë. Shërbimet shëndetësore ofrohen nga mjeku i praktikës së përgjithshme, psikiatri (me gjysmë orari), psikologu (me orar të plotë) si dhe personeli tjetër mjekësor. Personeli mjekësor përbëhet nga: 1 mjek, 1 psikolog, 1 psikiatër dhe 5 anëtar tjerë të personelit mjekësor. Ekipi monitorues është njoftuar se shërbimet e infermierisë në qendër ofrohen 24 orë. Shërbimet e kujdesit shëndetësor punojnë nën kushte të vështira, ishte vetëm një hapësirë në të cilën ofroheshin shërbimet e personelit mjekësor (të mjekut, personelit të infermierisë dhe psikiatrit) dhe psikologut. Ata iu ankuan ekipit monitorues për mungesë të hapësirës adekuate të punës. Gjatë vizitës, psikologu realizonte seanca psikologjike me të burgosurit në prani të personelit tjetër mjekësor, gjë që dëmton konfidencialitetin e trajtimit mjekësor. Menaxhmenti kishte ofruar një zyre e cila ishte refuzuar nga psikologu për shkak të mungesës së dritës natyrale dhe ventilimit. Për të gjitha shërbimet tjera pacientët dërgohen në spitalin regjional të Prizrenit. Personeli mjekësor ka shprehur shqetësimin e tyre lidhur me vonesat në marrjen e lejeve nga gjykata për dërgim të pacientëve (personat në paraburgim) në institucionet tjera mjekësore jashtë kësaj qendre të paraburgimit. Në rastin e të burgosurve leja lëshohet vetëm nga menaxhmenti. Për sa i përket referimit të pacientëve në shërbime mjekësore jashtë qendrës së paraburgimit, pacientët janë të ndarë në pacientë me prioritet “A” (nuk ka nevojë për leje nga gjykata), “B” dhe “C” (për të cilët leja nga gjykata duhet të merret). Ekzaminimi mjekësor bëhet një herë në muaj. Personeli mjekësor dhe ai i burgut kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me vendosjen e të burgosurve më probleme mentale në këtë objekt meqë nuk ka hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e tyre në Institutin e Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë.

Shënimet në vijim mbahen në njësinë e kujdesit shëndetësor: Protokollin mbi kontrollin mjekësor, të dhëna mbi vetë-lëndimet, të dhëna mbi lëndimet trupore, shënime mbi tentimet për vetëvrasje, shënime mbi vdekjet në qendër, shënime mbi keqtrajtime seksuale si dhe greva të urisë. Ekipi monitorues ka vërejtur se shënimet përmbanin informata të mjaftueshme.

Çështjet tjera

Personeli i burgut

Numri total i personelit të burgut është 103 (87 të uniformuar dhe 16 personel civil, 15 anëtar të personelit femra). Në kuadër të personelit të burgut janë edhe 2 punëtorë social (me orar të plotë). Ekipi monitorues ka vërejtur se personeli i burgut nuk kishte numër të mjaftueshëm të trajnimeve.

Disiplina

Sipas legjislacionit relevant (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale), personat e dënuar mund të ndëshkohen me dënimet disiplinore në vijim: qortim, privim nga privilegjet e caktuara, urdhri për kompensim dhe mbyllje në vetmi deri në 15 ditë. Të paraburgosurit mund të dënohen me ndalim ose kufizim të vizitave ose të korrespondencës (pos kontakteve me mbrojtësin, Avokatin e Popullit, përfaqësuesit e misionëve diplomatike, etj.), nëse kanë kryer ndonjë shkelje disiplinore të veçantë të cekur në ligj (asnjëra nga këto nuk është e lidhur me të drejtat e të burgosurve të kenë kontakt me botën e jashtme).

Personeli i burgut e ka njoftuar ekipin monitorues se masa disiplinore i mbylljes në vetmi nuk është aplikuar gjatë 3 viteve të fundit. Ekipi monitorues ka kërkuar që ti inspektoj qelitë e mbajtjes së personave në vetmi dhe ka vërejtur se ajo ishte shndërruar në depo për nevoja të burgut.

Kontakti me botën e jashtme

Sipas legjislacionit në fuqi, vizitat për të paraburgosurit janë të autorizuara dhe të drejtuara vetëm nga gjyqtari i procedurës paraprake. Ekipi monitorues është njoftuar nga të paraburgosurit se ata mund t'i kontaktojnë avokatët e tyre në çdo kohë, përfshirë këtu edhe fundjavat.

Procedura e pranimit

Para se të vendoset në këtë institucion i burgosuri i nënshtrohet kontrollit mjekësor në rast të ndonjë ankese ose lëndimi të dukshëm. Ka disa regjistra në zyre të pranimit, siç është: regjistri mbi pranimin, formulari mbi pranimin e të paraburgosurve dhe të burgosurve, etj. Para akomodimit të të paraburgosurve dhe të burgosurve këtu bëhet kontrollimi detal fizik (me rroba apo pa to).

Ankesat dhe procedurat

Të paraburgosurit dhe të burgosurit mund t'ia parashtrojnë ankesat e tyre menaxhmentit të qendrës së paraburgimit dhe Avokatit të Popullit përmes kutive për ankesa të vendosura në çdo krah të qendrës. Për sa i përket kutive për ankesa të vendosura nga Avokati i Popullit, vetëm personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit ka qasje në to. Ekipi monitorues është informuar nga të paraburgosurit dhe të burgosurit se zakonisht menaxhmenti përgjigjet në kërkesat dhe ankesat e tyre pa vonesë.

Konkludim:

- **Kushtet e përgjithshme në Qendrën e paraburgimit në Prizren duken të mira.**
- **Nuk kishte pohime për keqtrajtme nga personeli i qendrës së paraburgimit**

- **Qelitë për mbajtje ku të paraburgosurit ishin të akomoduar nuk ishin sipas standardeve ndërkombëtare.**
- **Personelit mjekësor i mungon hapësira adekuate për punë .**
- **Të burgosurit me probleme mentale nuk duhet të vendosen në këtë qendër.**